



BOSHLLËQE DHE MUNGESË KONSISTENCE NË DEKLARIMIN E PRONËS DHE INTERESAVE TË FUNKSIONARËVE NË RRUGËN DREJT ZBULIMIT TË KORRUPSIONIT

HULUMTIM

për zbulim të konfliktit të mundshëm të interesave dhe keqpërdorimit të pushtetit gjatë prokurimeve publike te personat politikisht të ekspozuar

BOSHLLËQE DHE MUNGESË KONSISTENCE NË DEKLARIMIN E PRONËS DHE INTERESAVE TË FUNKSIONARËVE NË RRUGËN DREJT ZBULIMIT TË KORRUPSIONIT

Botues:

Qendra për Komunikime Qytetare

Autorë:

Sabina Fakiq, German Fillkov dhe Pavle Gacov

Ekipi hulumtues:

Ivica Quçukova Nikollova, Pavlinka Strezoska, Marko Mitevski dhe Aleksandar Janev

Lektoroi në gjuhë maqedonase:

Tatiana B. Eftimoska

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:

Agon Ismaili

Dizajni figurativ dhe grafik:

Polyesterday, Shkup

Boton:

Polyesterday, Shkup

Tirazhi:

150

Qarkullim i lirë/jo-komercial

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.352:35.073.53]:342.518(497.7)"2022-2024"(047.31)

35.073.53:005.584.1(497.7)"2022-2024"(047.31)

342.518:[343.352:35.073.53(497.7)"2022-2024"(047.31)

ФАКИЌ, Сабина

Дупки и недоследности во пријавувањето сопственост и интереси на функционерите на патот на откривањето корупција : Истражување за откривање евентуални судири на интереси и злоупотреба на моќ при јавните набавки кај политички експонираните лица / [автори Сабина Факиќ, Герман Филков и Павле Гацов] = Boshllëqe dhe mungesë konsistence në deklarimin e pronës dhe interesave të funksionarëve në rrugën drejt zbulimit të korrupsionit : hulumtim për zbulim të konfliktit të mundshëm të interesave dhe keqpërdorimit të pushtetit gjatë prokurimeve publike te personat politikisht të eksponuar / [autorë Sabina Fakiq, German Fillkov dhe Pavle Gacov ; përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe Agon Ismail]. - Skopje : Centar za graѓanski комуникации = Shkup : Qendra për Komunikime Qytetare, 2025. - 20,20 стр. : илустр. ; 29 см

Текст на мак. и алб. јазик. - Фусноти кон текстот. - Содржи и: Boshllëqe dhe mungesë konsistence në deklarimin e pronës dhe interesave të funksionarëve në rrugën drejt zbulimit të korrupsionit : Hulumtim për zbulim të konfliktit të mundshëm të interesave dhe keqpërdorimit të pushtetit gjatë prokurimeve publike te personat politikisht të eksponuar. - Публикацијата е во рамки на проектот: "Користење на податоците за вистински сопственици за намалување на корупцијата"

ISBN 978-608-4974-45-1

1. Филков, Герман [автор] 2. Гацов, Павле [автор]

а) Корупција -- Функционери -- Македонија -- 2022-2024 -- Истражувања б) Јавни набавки -- Злоупотреба -- Мониторинг -- Македонија -- 2022-2024 -- Истражувања в) Функционери -- Јавни набавки -- Злоупотреба -- Македонија

-- 2022-2024 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 66265861

Projekti "Përdorimi i të dhënave të pronarëve të vërtetë me qëllim të reduktimit të korrupsionit" është i përkrahur nga Qeveria e Zvicrës nëpërmjet Civika mobilitas. Mendimet që janë shprehur në këtë botim nuk janë doemos reflektim i qëndrimeve të Qeverisë zvicerane, Civika mobilitas ose të organizatave që e zbatojnë këtë projekt.

PËRMBAJTJA


Gjetjet kryesore	3
Konteksti dhe qasja metodologjike	4
Rezultatet nga hulumtimi	6

Gjetjet kryesore



- Qasja tek të dhënat në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është as falas dhe as e lehtë.
- Përmes Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, janë zbuluar pronësi në kompani të individëve politikisht të eksponuar (kryetarë komunash dhe ministra), e që nuk i kanë të paraqitura në deklaratat e interesave që i kanë parashtruar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).
- Mospërputhja e të dhënave për interesat financiare të personave politikisht të eksponuar tregon për një mungesë të kontrollit dhe verifikimit adekuat mbi saktësinë e të dhënave si në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë ashtu edhe në deklaratat e interesave që personat e zgjedhur dhe të emëruar i parashtrojnë në KSHPK.
- Kompanitë në pronësi të kryetarëve aktualë të komunave dhe të ish-ministrave figurojnë si bartës të kontratave për prokurime publike, për koncesione dhe të licencave që u janë lëshuar nga institucionet shtetërore.
- Meqenëse në deklaratat e pasurisë dhe interesave duhet të paraqiten vetëm të dhënat për familjen më të ngushtë, jashtë kontrollit ngelin kompanitë në të cilat persona të afërt me rastet politikisht të eksponuar janë pronarë, themelues, partnerë, anëtarë të asamblesë, të bordit mbikëqyrës, të bordit të drejtorëve ose të menaxhmentit, ose janë persona të autorizuar në shoqëri tregtare (shtetërore dhe private). Kjo e bën të vështirë të zbulohet konflikti i interesave dhe keqpërdorimi i pozitës zyrtare në prokurimet publike nga personalitetet politike.
- Personat e zgjedhur dhe të emëruar deri në fund të vitit 2023 i kanë paraqitur deklaratat e interesit në një formular të vjetër, në të cilin është kërkuar të paraqiten interesat financiare edhe të personave të afërt me ta, kurse jo vetëm të anëtarëve të familjes së tyre, siç është përcaktuar me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave nga janari 2019. Së këtejmi, një pjesë e vogël e funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, megjithëse nuk e kanë pasur për detyrë sipas ligjit, ata kanë paraqitur informacione edhe për prindërit e tyre, vëllezërit, motrat dhe kushërinjtë e tyre.
- Paga për të dhëna nga Regjistri për Pronarët e Vërtetë edhe më tepër e forcon rëndësinë e të dhënave nga deklaratat e interesit që parashtrohen nga personat e zgjedhur dhe të emëruar. Prandaj, jashtëzakonisht është problematike që sistemi elektronik i KSHPK-së nuk ofron të dhëna për interesat e deklaruar të personave të zgjedhur dhe të emëruar, të cilët kanë dorëzuar deklaratat e tyre deri në vitin 2024. Konkretisht, për këta persona të zgjedhur dhe të emëruar, në dispozicion ka të dhëna vetëm për gjendjen e tyre pasurore, por jo edhe për interesat e tyre.
- Qytetarëve u është pamundësuar që në mënyrë aktive të marrin pjesë në zbulimin e konfliktit të mundshëm të interesave dhe keqpërdorimeve të pushtetit nga ana e bartësve të funksioneve. Regjistri për Pronarët e Vërtetë nuk është i hapur për publikun dhe qasja tek informacionet në të është me pagesë, ndërkohë që të dhënat për interesat financiare të funksionarëve që janë në sistemin elektronik të KSHPK-së nuk janë të plota.

Konteksti dhe qasja metodologjike



Potenciali i madh që kanë të dhënat mbi pronarët e vërtetë të kompanive në luftën kundër krimit dhe korrupsionit u bë i dukshëm menjëherë pas themelimit dhe publikimit të regjistrave të parë për pronarët e vërtetë nëpër vendet e botës, saktë një dekadë më parë.

Përveç idesë fillestare – për të parandaluar fshehjen e pronësisë mbi ndonjë kompani, realizimin e fitimeve të paligjshme dhe financimin e terrorizmit – zbulimi i pronarëve të vërtetë të kompanive është shndërruar në një mjet edhe për parandalimin e evazionit fiskal, keqpërdorimeve në ndarjen e prokurimeve publike, koncesioneve dhe fondeve të tjera publike.

Kështu, të dhënat mbi pronarët e vërtetë ose kryesorë përdoren për të hetuar dhe për të zbuluar raste korrupsioni; për vendimmarrje me qëllim që të zvogëlohen rreziqet për korrupsion dhe për krijimin e politikave dhe praktikave për parandalim të korrupsionit.

Në këtë kontekst, vlera e të dhënave mbi pronësinë e vërtetë për luftën kundër korrupsionit vjen veçanërisht nga përpunimi i kryqëzuar i tyre me informacione të tjera, ndërsa përdorimi inovativ i të dhënave është me rëndësi thelbësore për zgjerimin e përpjekjeve për transparencë dhe llogaridhënie në çdo nivel.

Rol thelbësor këtu kanë organizatat e shoqërisë civile dhe gazetarët hetimorë, të cilët veprojnë si bajpasues midis rregullores së re dhe ende të paqartë si dhe mundësive të mëdha që ata i identifikojnë tek të dhënat për pronarët e vërtetë.

Në shumë vende, pasi u zbuluan një sërë abuzimesh, janë bërë ndryshime në politika dhe praktika të rëndësishme me qëllim që të eliminohen shumica e praktikave korruptuese që kishin ndodhur para vendimit për t'u publikuar emrat e pronarëve të vërtetë. Së këtejmi, pikërisht organizatat e shoqërisë civile kanë ndihmuar në zhvillimin e atyre politikave dhe për sjelljen e vendimeve të rëndësishme në drejtim të qeverisjes më transparente, më të përgjegjshme dhe më efikase.

Për dallim nga vendet e tjera, megjithëse në vendin tonë Regjistri për Pronarët e Vërtetë është instaluar disa vite më parë nën presion prej partnerëve dhe organizatave të huaja, ai nuk aplikohet si mjet për të luftuar korrupsionin. Mirëpo, pavarësisht nivelit të aplikimit, regjistri ynë gjithashtu përmban të dhëna dhe ka potencialin që të përdoret si një instrument i tillë, veçanërisht duke i pasur parasysh korrupsionin shumë të përhapur në vend si dhe nevojën e skajshme që të intensifikohen lufta dhe përpjekjet për ta parandaluar atë.

Së këtejmi lindi ideja për këtë aktivitet projekti - **të dhënat e pronarëve të vërtetë të jenë baza për zbulimin e korrupsionit, zvogëlimin e rreziqeve nga korrupsioni dhe për miratimin e zgjidhjeve sistematike në këtë drejtim.**

Qëllimi i hulumtimit ishte të kontrollohet dhe të zbulohet nëse ekziston konflikt i mundshëm interesi dhe keqpërdorim me pushtetin në prokurimet publike nga personalitetet politike, ndërsa bazuar në përpunimin e kryqëzuar të të dhënave nga regjistri i sapothemeluar për pronarët e vërtetë me të dhënat nga regjistri i funksionarëve publikë të zgjedhur dhe të emëruar, me deklaratat e tyre të interesit dhe me të dhënat për kontratat e prokurimeve publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private që janë nënshkruar në vitet pas themelimit të regjistrat.

Të dhënat mbi pronarët e vërtetë mund të kontribuojnë për zbulimin e aktorëve të korruptuar, për sprapsjen e aktorëve të pandershëm nga abuzimi i mëtejshëm në prokurimet publike, për rritjen e konkurrencës dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve, si dhe për instalimin e mbikëqyrjes dhe kontroleve sistematike në drejtim të përmirësimit të prokurimeve publike.

Në hulumtim është përfshirë një shqyrtim i të dhënave të 360 zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të cilët kanë ndikimin më të madh në aspekt të kompetencave dhe autorizimeve të tyre dhe për të cilët ekzistojnë të dhëna në dispozicion, përkatësisht ekziston detyrimi për parashtrimin e deklaratës së interesit. Në këtë fazë, në hulumtim kanë qenë të përfshirë kryeqeveritarët, ministrat, zëvendësministrat, drejtorët e ndërmarrjeve dhe fondeve shtetërore, kryetarët e komunave dhe kryetarët e këshillave komunalë.

Duke pasur parasysh që synimi kryesor i hulumtimit ishte të kontrollohet dhe të zbulohet konflikt i mundshëm interesi dhe keqpërdorim i autorizimeve të personaliteteve politike në prokurimet publike, së pari është zhvilluar hulumtim që të zbulohet se cili funksionar (drejtpërsëdrejti ose përmes anëtarëve të familjes së tij të ngushtë me të cilët jeton) dhe në cilën kompani ka pronësi ose interes.

Për këtë qëllim, janë kontrolluar deklaratat e interesit që funksionarët i kanë parashtruar në KSHPK - për ato deri në janar 2024, në formë letre, ndërsa për ato pas janarit të vitit 2024, në formë elektronike. Pastaj, u zhvilluan kontrole në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë për të parë se cilët nga funksionarët kanë raportuar se janë pronarë kryesorë të kompanive, ndërkaq edhe për t'i verifikuar pronarët e vërtetë të kompanive, të cilët kanë qenë në vëmendjen e publikut, të përmendur në kontekste të afërsisë me ndonjë funksionar të caktuar ose kanë qenë bartës të kontratave për prokurime publike, koncesione për lëndë të para minerale, etj.

Pastaj, kompanitë e raportuara në deklaratat e interesit dhe kompanitë e zbuluara, pronarët e të cilave janë funksionarët dhe persona të afërt me ta, janë verifikuar në bazën e të dhënave të Sistemit Elektronik për Prokurime Publike për të kuptuar nëse kanë fituar kontrata për prokurime publike, sa kontrata dhe kur i kanë fituar. E njëjta është bërë edhe në bazat ekzistuese për kontrata të nënshkruara për koncesione dhe për partneritete publike-private.

Në secilën prej këtyre fazave të hulumtimit, u shfaqën probleme serioze, të cilat në fund të fundit e pengojnë përdorimin efikas të të dhënave për zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, ndërkaq të cilat janë përshkruar më hollësisht në pjesën e rezultateve të hulumtimit.

Bazuar në gjetjet nga ky hulumtim, edhe nga “Analiza mbi përdorimin e dhënave për pronarët e vërtetë në luftën kundër korrupsionit në Maqedoninë e Veriut” e zhvilluar më parë si dhe pas zhvillimit të konsultimeve publike, do të përpilohet një dokument për politika publike me rekomandime për përmirësimin e përdorimit të informacioneve për pronarët e vërtetë për t'i avancuar përpjekjet kundër korrupsionit në vend.

Rezultatet nga hulumtimi



■ Qasja tek të dhënat në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është as falas dhe as i lehtë.

Synim i hulumtimit të zhvilluar janë 360 funksionarë të zgjedhur dhe të emëruar në periudhën e viteve 2022 - 2024 (tre vitet e para nga themelimi i Regjistrit për Pronarët e Vërtetë), të cilët kanë qenë bartës në kategoritë e mëposhtme të funksioneve në nivel qendror dhe lokal:

- kryeministra;
- ministra;
- zëvendësministra;
- kryetarë të komunave;
- kryetarë të këshillave komunalë;
- drejtorë të fondeve shtetërore dhe
- drejtorë të ndërmarrjeve shtetërore të themeluara nga Parlamenti dhe nga Qeveria.

Personat e zgjedhur dhe të emëruar që ishin fokus i analizës kanë qenë ose akoma janë bartës të këtyre funksioneve.

Për informacionet për të mësuar nëse ndonjë person fizik konkret është aktualisht pronari i vërtetë i ndonjë kompanie, Regjistrin Qendror duhet t'i paguhen 300 denarë, ndërsa 800 denarë kushtojnë të dhënat lidhur me atë nëse ndonjë person fizik ka qenë pronar i vërtetë në të kaluarën.

Për më tepër, në rast se në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë ka më tepër persona me të njëjtin emër dhe mbiemër, atëherë është e nevojshme që të merret edhe informacioni për muajin dhe vitin e lindjes së individit për të cilin kërkohen të dhënat nga Regjistri. Mirëpo, këto të dhëna janë të dobishme t'i kemi edhe atëherë kur vetëm një person me emër dhe mbiemër konkret është i regjistruar në sistem. Më konkretisht, nëse nuk i kemi të dhënat për muajin vitin e lindjes, ekziston rreziku që të marrim të dhëna për ndonjë person fizik i cili nuk është person i zgjedhur dhe/ose i emëruar, por ka vetëm të njëjtin emër dhe mbiemër.

Për shembull, me të njëjtin emër dhe mbiemër janë regjistruar anëtarë të këshillave të dy komunave. Në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, një person fizik ka qenë i regjistruar me atë emër dhe mbiemër si pronarë e një kompanie. Megjithatë, një verifikim i mëtejshëm i të dhënave çoi në konstatimin se nuk bëhet fjalë për asnjërin nga të dy anëtarët me të njëjtin emër në të dy këshillat komunalë, por për person të tretë.

Në një situatë ku shumë institucione nuk i publikojnë biografitë e bartësve të funksioneve publike, qasja tek të dhënat për muajin dhe vitin e lindjes është një sfidë e vërtetë. E gjithë kjo e bën të vështirë dhe të ndërlikuar përdorimin e të dhënave nga Regjistri për Pronarët e Vërtetë.

Përveç kësaj, që të merret ndonjë informacion për pronarët e vërtetë të një kompanie të caktuar, duhet të dini edhe numrin unik amë të asaj kompanie (NUAS) dhe të paguani 299 denarë, ose 600 denarë, për informacionet se kush kanë qenë pronarët e vërtetë në të kaluarën.

Në hulumtimin që ka përfshirë të lartpërmendurit 360 persona të zgjedhur dhe të emëruar, nuk kishte mundësi që për secilin prej tyre të gjenden informacionet për muajin dhe vitin e lindjes me qëllim që të mund të verifikohet nëse ata janë pronarët e vërtetë të ndonjë kompanie, pavarësisht të gjitha përpjekjeve dhe kërkimeve që janë bërë në faqet zyrtare të internetit të institucioneve, si dhe në rrjetet sociale. Në fund, nga Regjistri për Pronarët e Vërtetë janë gjetur të dhëna për 339 nga 360 personat e zgjedhur dhe të emëruar që ishin subjekt i analizës, pasi për të tjerët nuk mund të gjendej data e lindjes.

■ **Përmes Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, janë zbuluar pronësi në kompani të individëve politikisht të eksponuar (kryetarë komunash dhe ministra), e që nuk i kanë të paraqitura në deklaratat e interesave që i kanë parashtruar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).**

Funksionarët e kanë për detyrë që në afat prej 30 ditësh nga fillimi i ushtrimit të kompetencave dhe detyrave publike të parashtrojnë deklaratë të pasurisë dhe interesave në KSHPK¹. Në deklaratën, në seksionin e interesave, ata duhet të deklarojnë nëse janë pronarë, themelues, partnerë, anëtarë të asamblesë, të këshillit mbikëqyrës, të bordit të drejtorëve ose të menaxhmentit, apo janë persona të autorizuar në ndonjë shoqëri tregtare.

Ndërkaq në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, evidentohen aksionet pronësore në subjektet juridike që janë më tepër se 25%². Me të drejtë pritet që të dhënat e regjistruara në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë të jenë identike me të dhënat e shënuara në deklaratat e paraqitura të interesit.

Megjithatë, hulumtimi i zhvilluar përmes një analize paralele mbi të dhënat e paraqitura në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë dhe të dhënat në deklaratat e interesit të paraqitura në KSHPK nxjerr në pah mospërputhshmëri.

Analiza e detajuar mbi të dhënat që janë siguruar nga Regjistri për Pronarët e Vërtetë tregon që 41 person, apo 12.1% nga numri i përgjithshëm i analizuar, shfaqen si pronarë të kompanive. Ndërkaq, personalitetet politike që kanë kompani, në të shumtën e rasteve kanë më tepër se vetëm një.

Rezultatet nga hulumtimi në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë

Lloji i funksionit në periudhën e viteve 2022–2024	Numri i funksionarëve (sipas kategorive të funksioneve) që ishin subjekte të hulumtimit	Të dhënat e siguruar nga Regjistri për Pronarët e Vërtetë	Shfaqen si pronarë të kompanive	Përqindja e personave të cilët janë pronarë të vërtetë të kompanive
Kryeministrat, ministrat dhe zëvendësministrat	123	121	16	13.2%
Kryetarët komunave	81	79	8	10.1%
Kryetarët e këshillave komunalë	81	74	9	12.2%
Menaxherët e fondeve	15	14	1	7.1%
Drejtorët e ndërmarrjeve shtetërore	60	51	7	13.7%
Gjithsej	360	339	41	12.1%

¹ Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 12/2019).

² Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 151/2022 dhe 208/2024).

Sipas të dhënave në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, këta 41 individ shfaqen si pronarë të vërtetë në gjithsej 72 kompani.

Megjithatë, kur u krahasuan këto të dhëna të siguruar nga Regjistri për Pronarët e Vërtetë me të dhënat që funksionarët i kanë paraqitur në deklaratat e interesit të paraqitura në KSHPK, u konstatua se gjysma e funksionarëve i kanë fshehur aksionet e tyre të pronësisë në kompanitë. Përkatesisht, madje 23 persona i kanë fshehur tërësisht ose pjesërisht, aksionet e tyre të pronësisë në kompanitë. Më konkretisht, 17 individë fare nuk i kanë deklaruar 18 kompanitë në të cilat kanë pjesëmarrje pronësore, ndërsa 6 individë, në vend që të paraqesin 34 kompani, kanë paraqitur vetëm 9 kompani në deklaratat e tyre të interesit. Në deklaratat e parashtruara në KSHPK mungojnë gjithsej 43 kompani për të cilat të dhënat tregojnë se janë në pronësi të funksionarëve që figurojnë në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë.

Nga mospërputhja e detektuar e të dhënave, mund të veçohen disa raste që sugjerojnë në fshehjen e interesave financiare të personaliteteve politike.

Rasti i parë ka të bëjë me një kryetar komune, i cili në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë është i evidentuar si pronar në 5 shoqëri tregtare, me aksione nga 34% e deri 100%. Në deklaratën e tij të interesit, ky kryetar komune ka deklaruar pronësinë vetëm në dy nga pesë kompanitë. Tre kompanitë tjera nuk janë të paraqitura në deklaratën e parashtruar të interesit. Megjithatë, disa nga këto kompani figurojnë si bartëse të kontratave për prokurime publike dhe për koncesion për gërmimin e lëndëve të para minerale.

Si një shembull i dytë tregues, mund të veçohen mospërputhjet e detektuara në lidhje me pronësinë e një kryetari të një komune tjetër. Më saktësisht, në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, ai figuron si pronar i vërtetë në dy shoqëri tregtare, edhe atë në secilën prej tyre me aksione prej 33.3%. Në deklaratën e interesit që e ka parashtruar në KSHPK ai e ka paraqitur pjesëmarrjen e tij pronësore në njërin nga kompanitë në fillim të mandatit të tij të dytë si kryetar komune, më 17 dhjetor 2021, në formë të shtypur. Por, nuk e ka paraqitur pronësinë e fituar në fund të vitit 2022 për kompaninë e dytë. Ajo që paqartësinë e bën edhe më të madhe, është fakti që në bazën e të dhënave elektronike të deklaratave të interesit, e cila tani është në dispozicion në faqen e internetit të KSHPK-së, nuk ka të dhëna se ky kryetar komune ka deklaruar çfarëdo pjesëmarrje pronësore në ndonjë kompani. Kjo është një anomali në sistemin elektronik që e drejton KSHPK-ja. Për të gjithë bartësit e funksioneve që kanë parashtruar deklaratat të pasurisë dhe interesit deri më datën 31.12.2023, në këtë sistem, në dispozicion për publikun janë vetëm të dhënat për pasurinë, por jo edhe të dhënat e interesit.

Një tjetër kryetar komune, përveç pronësisë në dy kompani që e ka deklaruar në KSHPK, gjithashtu figuron si themelues i një kompanie të tretë. Konkretisht, ky kryetar komune në deklaratën e interesit ka paraqitur 100% pronësi në dy kompani. Megjithatë, në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, përveç këtyre dy shoqërive tregtare, ai është i regjistruar edhe si pronar me 33% pjesëmarrje pronësore në një kompani të tretë.

Një mospërputhje e madhe në të dhënat është detektuar edhe në rastin e një ish-anëtarit të Qeverisë. Në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, ai figuron si pronar aksionesh prej 25% deri në 80%, edhe atë në 20 kompani. Megjithatë, në deklaratën e interesit të parashtruar në KSHPK, ai ka paraqitur vetëm dy kompani, njëra prej të cilave në procedurë të shitjes. Rezulton se diferenca është madje me 19 kompani. Nëse kërkohet logjikë në një mënyrë të këtillë veprimi, rezulton se në deklaratat e interesave kanë qenë të paraqitura vetëm kompanitë në të cilat Zëvendëskryeministri i atëhershëm ka qenë themelues i drejtpërdrejtë, por jo edhe aksionet që ai i ka zotëruar në kompanitë e tjera të themeluara nga ato të parat. Një nga kompanitë që nuk është paraqitur në Deklaratën e Interesave të këtij ish-funksionari shfaqet si bartëse e një kontrate për prokurime publike.

Për më tepër, një kryetar komune, në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, shfaqet si pronar i një institucioni privat shëndetësor, ndërsa këtë nuk e ka paraqitur në deklaratën e interesave të parashtruar në KSHPK.

Gjithashtu, një ish-ministër është i regjistruar në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë si pronari absolut i një farmacie. Megjithatë, në deklaratën e interesave të atij ish-ministri, subjekti juridik farmaceutik është i paraqitur si pronë e gruas së tij.

Mospërputhje e të dhënave është detektuar edhe për një zëvendësministër, e cila në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë shfaqet si pronare në dy shoqëri tregtare, në njërin me 100% pronësi dhe në të dytën me 50% pjesëmarrje pronësore. Ndërkaq, në deklaratën e interesave është paraqitur pronësi vetëm në kompaninë ku aksionet janë 100%, kurse në të dytën, ajo është e paraqitur vetëm si drejtor, por jo edhe si pronare. Në të kaluarën, kompanitë e Zëvendësministres kanë nënshkruar kontrata për prokurime publike.

Duke i pasur parasysh këta si dhe shembuj të tjerë të zbuluar në këtë hulumtim, shtrohet pyetja – në çka mund të besojmë. Nëse deklaratat e interesit nuk janë plotësisht të besueshme, a janë të besueshme të dhënat në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë?

■ **Mospërputhja e të dhënave për interesat financiare të personave politikisht të eksponuar tregon për mungesë të kontrollit dhe verifikimit adekuat mbi saktësinë e të dhënave si në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë ashtu edhe në deklaratat e interesave që personat e zgjedhur dhe të emëruar i parashtrojnë në KSHPK.**

Një mospërputhje është vërejtur në rast me një ish-ministër, i cili në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë figuron si pronar me 50% pjesëmarrje në një shoqëri tregtare, ndërsa në deklaratën e interesit është deklaruar se kompania është 100% në pronësi të vet.

Gjatë hulumtimit, është zbuluar edhe një rast i një kryekëshilltari komunal, i cili në deklaratën e interesave që e ka parashtruar në shtator të vitit 2021, ka deklaruar se zotëron 25% të aksioneve në një kompani për shpediton, tregti dhe shërbime. Pronësia e tillë nuk është e evidentuar në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, ku regjistrimi është bërë në prill të vitit 2021 ndërsa nuk mund të gjendet as në të ashtuquajturën Histori për pronarët e vërtetë të subjektit të selektuar.

Paqartësi krijojnë edhe vetë deklaratat e interesit që janë të publikuara në sistemin elektronik të KSHPK-së, në të cilat nuk specifikohet përqindja e pjesëmarrjes pronësore të funksionarit dhe si rrjedhojë nga kjo, nuk mund të verifikohet vërtetësia e plotë e të dhënave të paraqitura. I tillë është shembulli me një bartës të funksionit të drejtorit, i cili nuk është i regjistruar në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë, ndërsa në deklaratën e tij të interesit, ai vetë ka deklaruar pronësi në disa shoqëri tregtare. Në mënyrë indirekte, kjo mund të interpretohet sikur aksionet e tij në kompanitë e raportuara janë më pak se 25%. Por kjo sigurisht që imponon nevojën për përmirësimin e sistemit të deklaratave të interesit duke mundësuar të paraqiten dhe të bëhen publike edhe përqindjet e pronësisë.

Për më tepër, në kuadër të hulumtimit, janë detektuar disa shembuj ku bartës të funksioneve heqin dorë nga pronësia e kompanive. Prandaj, shtrohet pyetja nëse këto ndryshime janë bërë vetëm për të fshehur interesin pas ndonjë personi anonim apo nëse bëhet fjalë për transferim real të pronësisë.

Verifikimi i saktësisë së të dhënave është i rëndësishëm jo vetëm nga perspektiva e zbulimit të pronësisë që personalitetet politike e kanë mbi shoqëritë tregtare, por edhe për detektimin e rasteve kur personat e zgjedhur dhe të emëruar bëjnë transferim formal të pronësisë së kompanive të tyre të persona të tjerë, por interesi i tyre afarist në ato kompani mbetet.

Në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, KSHPK ka kompetencën për verifikimin e të dhënave nga deklaratat e pasurisë dhe interesit. Më konkretisht, sipas nenit 92 të Ligjit, KSHPK-ja e verifikon vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në deklaratën e pasurisë dhe interesit në rastet kur vepron për ndonjë rast konkret ose në bazë të planit vjetor.

Në praktikë, ky detyrim kryhet në vëllim shumë të kufizuar, përkatësisht numri i verifikimeve të kryera nga KSHPK-ja në këtë aspekt është shumë i vogël. Sipas raportit vjetor për punën e KSHPK-së për vitin 2024³, për sa i përket verifikimit të të dhënave në deklaratat, KSHPK-ja ka kryer 14 verifikime në përputhje me planin vjetor dhe 30 verifikime gjatë veprimit për një rast konkret, nga të cilat, 6 me iniciativë të KSHPK-së dhe 24 në bazë të denoncimeve.

Paralelisht me verifikimin e deklaratave të interesit, ekziston nevoja edhe për verifikimin e informacioneve në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë. Gjatë kësaj, ky kontroll duhet të mundësojë verifikimin e saktësisë së të dhënave të shënuara, si dhe të ndryshimeve që janë bërë në pronësinë e vërtetë, duke përfshirë verifikimin e origjinës së parave dhe kapaciteteve financiare edhe të pronarëve të mëparshëm edhe të pronarëve të rinj. Në rastet e transferimit të pronësisë pa kompensim, të kontrollohet profili i pronarit. Çdo aktivitet i dyshimtë duhet të raportohet tek institucionet kompetente për hetime të mëtejshme.

³ Raporti vjetor mbi punën e KSHPK-së për vitin 2024, mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm (16.05.2025): https://dksk.mk/wp-content/uploads/2025/03/%D0%93%D0%98-%D0%B7%D0%B0-%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%94%D0%9A%D0%A1%D0%9A-%D0%B7%D0%B0-2024_%D0%B7%D0%B0-web-%D0%B1%D0%B5%D0%B7-%D0%BF%D1%80%D0%B8%D0%BB%D0%BE%D0%B7%D0%B8.pdf

■ **Kompanitë në pronësi të kryetarëve aktualë të komunave dhe të ish-ministrave figurojnë si bartës të kontratave për prokurime publike, për koncesione dhe të licencave që u janë lëshuar nga institucionet shtetërore.**

Qëllimi i deklaratave të interesit që i parashtrajnë personat e zgjedhur dhe të emëruar është, ndër tjerash, të zbulohet interesi potencial afarist i tyre dhe të monitorohet bartësi i funksionit të mos abuzojë me pushtetin e besuar gjatë ndarjes së kontratave për prokurime publike ose të kontratave tjera shtetërore, përfitimëve dhe privilegjeve, duke shkelur barazinë në treg. Fshehja e interesave financiare është alarmi i parë i kuq që ndizet kur bëhet fjalë për personalitetet politike.

Zbulimi se personalitete politike, në deklaratat e tyre të interesit, nuk i kanë paraqitur kompanitë që janë të evidentuara në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë tashmë e ka aktivizuar këtë alarm të kuq.

Faza tjetër e hulumtimit ishte në lidhje me kontrollimin mbi këto kompani në Sistemin Elektronik të Prokurimeve Publike, me qëllim që të shihet nëse ato shfaqen si bartës të prokurimeve publike, si dhe të kontrollohen bazat e të dhënave për koncesionet dhe marrëveshjet për themelim të partneriteteve publiko-private që janë dhënë nga shteti. Në rastet kur kompanitë në fjalë shfaqen si bartës të prokurimeve publike, kontrollohet nëse ka ndryshim në vlerën e tyre para dhe pas fillimit të funksionit.

Si gjetje më të rëndësishme nga ai proces mund të theksohen këto si në vijim.

Kryetarët e komunave që kanë pjesëmarrje pronësore në shoqëri tregtare, natyrisht, nuk u kanë mundur atyre shoqërive tregtare të nënshkruajnë kontrata me komunat që ata i udhëheqin. Megjithatë, është vërejtur se në disa nga kompanitë në pronësi të tyre ka një rritje në vlerën e kontratave për prokurime publike që janë nënshkruar pas ardhjes së tyre në ato poste. Interpretimi i kësaj gjithësi mund të jetë që pushteti i tyre politik ka rezultuar me ndikime të caktuara.

Pra, një kompani në të cilën një kryetar komune ka 100% pronësi, gjatë pesë viteve para fillimit të mandatit të tij, përkatësisht në periudhën e viteve 2013 - 2017 ka kontrata për prokurime publike me vlerë prej 25 milionë denarë (406 mijë euro), ndërsa në pesë vitet pas fillimit të mandatit (2018 - 2022) - rreth 90 milionë denarë (ose 1.5 milion euro), përkatësisht dy herë e gjysmë më tepër. Një kompani tjetër në pronësi të të njëjtit kryetar komunal, në të cilën ai ka 75% të aksioneve, në pesë vitet para ardhjes së tij në funksion, ka realizuar një vlerë totale të kontratave për prokurime publike prej 47 milionë denarë, ndërsa në periudhën tjetër pesëvjeçare që kur ai është kryetar komune, rreth 111 milionë denarë, ose 77% më shumë. Është e rëndësishme të theksohet se një depërtim të madh në tregun e prokurimeve publike ka realizuar edhe kompania e një individi-pronar, me të cilin ky kryetar komune ka një kompani tjetër të përbashkët.

Një kryetar komune, i cili dy mandate është në krye të komunës së njëjtë, ka fituar pronësinë e dy kompanive në dhjetor të vitit 2022. Duket sikur këto pjesëmarrje pronësore janë rezultat i ndryshimeve në suazat e pronësisë familjare, bazuar në mbiemrat e njëjtë të personit në vend të të cilit fitohet pronësia. Megjithatë, në qershor të vitit 2024, njëra nga këto kompani ka fituar licencë për të ushtruar veprimtari energjetike - prodhim i energjisë elektrike nga elektrocentral fotovoltaike.

Nga perspektiva e nivelit të bartësve të funksioneve në nivel lokal, me rëndësi është të theksohet edhe rasti i kryetarit të një këshilli komunal, i cili gjatë mandatit të tij ka nënshkruar dy kontrata për prokurime publike me komunën. Këto janë kontrata për shërbime gjeodezike në vlerë të përgjithshme prej 600.002 denarë (9.756 euro). Kryetari i këshillit, në ato kontrata për prokurimet publike madje është nënshkruar në cilësinë si drejtor i shoqërisë tregtare.

Në kuadër të hulumtimit janë zbuluar edhe një numër rastesh të tjera, nga të cilat veçohet shembulli në vijim, ndërkaq i cili ka të bëjë me një ish-anëtar të Qeverisë. Kompanitë e tij kanë qenë bartës edhe të kontratave për koncesione, ndërsa njëra nga kompanitë, në të cilën ai ka pasur pjesëmarrje të tërthortë pronësore prej 40%, në periudhën e viteve 2014-2024 ka nënshkruar 78 kontrata me vlerë prej 320 milionë denarë (5.2 milionë euro). Por, gjatë mandatit, kjo kompani ka nënshkruar vetëm një kontratë me vlerë prej 2.3 milionë denarë (37 mijë euro).

Gjithashtu ka një rast ku një ministër ka themeluar një kompani gjatë ushtrimit të funksionit publik. Duke e pasur parasysh që kompania ka realizuar të ardhura gjatë periudhës që ministri ka qenë në funksion, kjo gjithashtu është një dobësi e sistemit për parandalimin e konfliktit të interesave dhe korrupsionit.

Duke marrë parasysh këta shembuj, është padyshim shumë e rëndësishme që të publikohen pronarët e vërtetë, para dhe pas largimit të personaliteteve politike nga funksioni. Transparenca për pronësinë në kontratat për prokurime publike dhe koncesionet e ndara do të mundësojë që qytetarët të kenë një pasqyrë të plotë në lidhje me proceset.

- **Meqenëse në deklaratat e pasurisë dhe interesave duhet të paraqiten vetëm të dhënat për familjen më të ngushtë, jashtë kontrollit ngelin kompanitë, në të cilat persona të afërt me rastet politikisht të eksponuar janë pronarë, themelues, partnerë, anëtarë të asamblesë, të bordit mbikëqyrës, të bordit të drejtorëve ose të menaxhmentit, ose janë persona të autorizuar në shoqëri tregtare (shtetërore dhe private). Kjo e bën të vështirë të zbulohet konflikti i interesave dhe keqpërdorimi i pozitës zyrtare në prokurimet publike nga personalitetet politike.**

Në kushtet kur vlera e prokurimeve publike dhe e kontratave tjera publike vazhdimisht rritet, ndërsa korrupsioni, sipas të gjitha vlerësimeve, vazhdon të jetë i përhapur, me të drejtë mund të vlerësohet se ekziston një rrezik i lartë që kompanitë, në të cilat pjesëmarrje pronësore kanë persona të afërt me bartësit e funksioneve, të jenë të privileguara për t'i fituar kontratat për prokurime publike, koncesione, partneritete publiko-private dhe të tjera.

Gjithashtu është problematike që deklaratat e pasurisë dhe të interesave hiqen nga faqja e internetit e KSHPK-së pas përfundimit të mandatit të personave të zgjedhur dhe të emëruar.

Kjo vetëm e bën më të madhe nevojën për lidhje publike të të dhënave nga Regjistri për Pronarët e Vërtetë me Sistemin Elektronik për Prokurime Publike, si një hap i parë drejt përdorimit efikas të këtyre të dhënave në forcimin e luftës kundër korrupsionit.

Një tjetër mospërputhje në sistem që e bën të vështirë këqyrjen dhe verifikimin e plotë të të dhënave është se vetë zyrtarët i shënojnë emërtimet e kompanive në të cilat kanë interesa. Kjo shumë shpesh bëhet me emra të paplotë dhe të pasaktë të kompanive, të cilat më pas nuk mund t'i gjejnë në Regjistrin Qendror dhe në bazat e tjera të të dhënave. Gjithashtu nevojitet shumë kohë për t'u vërtetuar emri i saktë i kompanisë që më pas të bëhen verifikimet.

Kjo mospërputhje mund të zgjidhet duke instaluar lidhje automatike të Regjistrit Qendror me sistemin në të cilin të dhënat nga deklaratat e pasurisë dhe interesave regjistrohen në formë elektronike. Në këtë mënyrë, emrat e kompanive do të përzgjedhen nga Regjistri Qendror dhe kompanitë do të shfaqen me emrat e tyre të plotë dhe të saktë, gjë që më tutje do të mundësojë edhe verifikim edhe këqyrje më të lehtë. Një lidhje e tillë është bërë tashmë në Sistemin Elektronik për Prokurime Publike, në të cilin, përzgjedhja e emrave të kompanive që fitojnë dhe marrin pjesë në tenderët bëhet automatikisht nga Regjistri Qendror.

- **Personat e zgjedhur dhe të emëruar, deri në fund të vitit 2023, deklaratat e interesave i kanë parashtruar në një formular të vjetër ku është kërkuar deklarim i interesave financiare edhe për persona të afërt me ta, e jo vetëm për anëtarët e familjeve të tyre, siç është përcaktuar me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave i miratuar në janar të vitit 2019. Së këtejmi, një pjesë e vogël e funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, megjithëse nuk e kanë pasur detyrim ligjor, ata kanë paraqitur informacione edhe për prindërit, vëllezërit, motrat dhe kushërinjtë e tyre.**

Në përputhje me versionin aktual të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave⁴ (Neni 119, paragrafi (5)), Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, në afat prej 60 ditësh nga dita e konstituimit, e ka për detyrë ta përcaktojë formularin për deklarimin e pasurisë dhe interesave. Nevoja për këtë u shfaq për shkak të gërshetimit të dy teksteve të mëparshme ligjore – atë për parandalim të korrupsionit⁵ dhe për konflikt të interesave⁶, në një tekst ligjor dhe së këtejmi edhe të gërshetimit të dy formularëve të deklaratave të mëparshme – për gjendjen pasurore dhe atë të interesave, në një deklaratë të vetme. Megjithatë, formulari i asaj deklarate të përbashkët u përpilua madje katër vite pas miratimit të ligjit, me miratimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e formularit për të dhënat e personave të zgjedhur dhe të emëruar⁷, më 14 shkurt të vitit 2023. Megjithatë, zbatimi praktik i formularit të ri do të fillojë më 1 janar të vitit 2024, me instalimin e sistemit të ri elektronik të KSHPK-së. Paraprakisht janë bërë ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores dhe përcaktimi përfundimtar i formularit për Deklaratën e për gjendjen pasurore dhe të interesave si dhe për paraqitjen e ndryshimeve⁸.

Përveç kësaj, është problematike që versioni i vjetër i formularit të deklaratës së interesave⁹, të cilin personat e zgjedhur dhe të emëruar e kanë përdorur deri më 31.12.2023, përmban një udhëzim për plotësim sipas të cilit, në lidhje me shoqëritë tregtare, duhet të paraqiten të dhëna edhe për “persona të afërt”, të cilët janë pronarë, themelues, partnerë, anëtarë të asamblesë, të këshillit mbikëqyrës, të bordit të drejtorëve ose të udhëheqësisë, ose janë persona të autorizuar në shoqëri tregtare (shtetërore dhe private). Në këtë mënyrë, me nocionin “person i afërt” nënkuptohen personat në bashkësi martesore ose jashtëmartesore me personin zyrtar; farefis sipas gjakut në vijë të drejtë (bir e bijë, nipër e mbesa, baba e nënë, gjysh e gjyshe); farefis në vijë anësore deri në shkallë të katërt (vëlla dhe motër e prindërve, kushërinj të parë dhe të dytë); prindi adoptues dhe fëmija i adoptuar; farefisi sipas krushqisë deri në shkallën e dytë (babai dhe nëna, vëlla dhe motër si dhe kushërinjtë e bashkëshortit / bashkëshortes); dhe çdo person fizik ose person juridik me të cilin zyrtari ka interes privat-afarist. Në fund të vitit 2018, Gjykata Kushtetuese e hoqi segmentin për “farefis në vijë anësore” dhe “farefis sipas krushqisë” nga përfshirja e nocionit “persona të afërt” në këtë deklaratë të interesave¹⁰.

Me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave nga janari i vitit 2019 u bë reduktim i mëtejshëm i përfshirjes së personave për të cilët një person zyrtar duhet të deklarojë interesa. Kështu, detyrimi i ri nuk i përfshin “personat e afërt” dhe kufizohet vetëm me “anëtarë të familjes me të cilët personat e zgjedhur dhe të emëruar jetojnë në ekonomi të përbashkët familjare”. Prandaj, ligji dhe formulari që janë përdorur deri në fund të vitit 2023 nuk kanë qenë të harmonizuar.

Por, pavarësisht mospërputhjes së këtyre të formularit, praktika tregon që personat e zgjedhur dhe të emëruar thuhet kurrë nuk

⁴ Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 12/2019).

⁵ Për Parandalimin e Korrupsionit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 28/2002, 46/2004, 126/2006, 10/2008, 161/2008, 145/10, 97/15 dhe 148/15).

⁶ Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 70/2007, 114/2009, 6/2012 dhe 153/2015).

⁷ Rregullore për formën dhe përmbajtjen e formularit për të dhënat e personave të zgjedhur dhe të emëruar, KSHPK, 14.02.2023, mund ta gjeni në linkun si vijon (16.05.2025): [Правилник-за-форма-и-содржина-на-образецот-за-податоци-на-избрани-и-именувани-лица.pdf](#) (Rregullore-për-formën-dhe-përmbajtjen-e-formularit-për-të-dhënat-e-personave-të-zgjedhur-dhe-emëruar.pdf)

⁸ Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për formën dhe përmbajtjen e formularit të deklaratës për gjendjen pasurore dhe interesin dhe raportimin e ndryshimeve në gjendjen pasurore dhe të interesave, KSHPK, 28.12.2023. mund ta gjeni në linkun si vijon (16.05.2025): [08-2059-3.pdf](#)

⁹ Deklarata e Interesave, KSHPK, mund ta gjeni në linkun si në vijim (16.05.2025): <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/12/izjavazainteresiNMK.pdf>

¹⁰ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese R. numër 24/2018-1 i datës 25.12.2018, mund ta gjeni në (16.05.2025): <https://ustavensud.mk/archives/17322>

kanë deklaruar interesa për persona që nuk janë anëtarë të familjeve të tyre. KSHPK-ja këtë e shpjegon me udhëzimet që ata ua kanë dhënë personave të zgjedhur dhe të emëruar për t'iu përmbajtur Ligjit, e jo udhëzimit që ka qenë në formularin.

Sipas hulumtimit të zhvilluar, nga 360 persona, të cilëve u janë shqyrtuar deklaratat e interesave të parashtruara në KSHPK, rezultojnë se vetëm 29 persona kanë shënuar ndonjë kompani në të cilën një “person i afërt” me ta ka pjesëmarrje pronësore ose është drejtor.

Por rezultojnë se këta 29 persona kanë raportuar, edhe pse nuk kanë pasur asnjë detyrim ligjor për të vepruar në këtë mënyrë. Kjo situatë shpie në vlerësimin se fakti që paraqitja e informacioneve në deklaratat e pasurisë dhe interesave vlen vetëm për anëtarët e familjes me të cilët personat e zgjedhur dhe të emëruar jetojnë në të njëjtën ekonomi familjare është tepër e kufizuar dhe kjo nuk mundëson zbulimin e konfliktit të mundshëm të interesave dhe abuzimit të kompetencave gjatë procedurave për prokurime publike nga personalitetet politike.

Interesi i deklaruar për person të afërt në shoqëri tregtare

Lloji i funksionit në periudhën e viteve 2022–2024	Numri i përgjithshëm funksionarëve që ishin subjekt i hulumtimit	Interesi i deklaruar për person të afërt në shoqëri tregtare	Përqindja e funksionarëve që kanë deklaruar interes për ndonjë person të afërt
Kryeministra, Ministra dhe Zëvendësministra	123	15	12.20 %
Kryetarët e komunave	81	9	11.11%
Kryetarët e këshillave komunalë	81	0	0
Menaxherët e fondeve	15	2	13.33%
Drejtorët e ndërmarrjeve shtetërore	60	3	5.00 %
Gjithsej	360	29	8.05%

- **Pagesa për të dhënat në Regjistrin për Pronarët e Vërtetë edhe më tepër e forcon rëndësinë e të dhënave nga deklaratat e interesit që parashtrihen nga personat e zgjedhur dhe të emëruar. Prandaj, jashtëzakonisht është problematike që sistemi elektronik i KSHPK-së nuk ofron të dhëna për interesat e deklaruar të personave të zgjedhur dhe të emëruar, të cilët kanë parashtruar deklarata deri në vitin 2024. Më konkretisht, për këta persona të zgjedhur dhe të emëruar, në dispozicion ka të dhëna vetëm për gjendjen e tyre pasurore, por jo edhe për interesat e tyre.**

Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave është i qartë dhe në të është përcaktuar që personi i zgjedhur ose i emëruar, personi përgjegjës në ndërmarrjen publike, institucionin publik ose në ndonjë subjekt tjetër juridik që disponon me kapital shtetëror, noteri, përmbaruesi, nëpunësi administrativ i kategorisë A të përcaktuar me ligj ose personat e punësuar në kabinetet Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, të nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, zëvendëskryetarët e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ministrat dhe sekretari i përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për shkak të kryerjes së detyrave të punës të këshilltarit të veçantë, gjatë zgjedhjes, emërimit, përkatësisht punësimit, e më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e zgjedhjes, emërimit, caktimit, përkatësisht punësimit, parashtron deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat. I njëjti afat prej 30 ditësh vlen edhe për paraqitjen e ndryshimeve në gjendjen pronësore dhe interesat.

Megjithatë, në praktikë, personat e zgjedhur dhe të emëruar nuk i respektojnë këto detyrime në mënyrë konsekuente dhe nuk është e pazakontë që ndonjë person konkret i zgjedhur apo i emëruar të jetë i përfshirë në regjistrin me një deklaratë pasurie dhe interesi, e të cilën e ka parashtruar nga funksioni i mëparshëm dhe jo nga funksioni aktual.

Në këtë mënyrë shfaqen mospërputhje mes të dhënave në Regjistrin e Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar dhe të dhënave për gjendjen pasurore dhe interesat. Në një numër të konsiderueshëm rastesh, deklaratat nuk janë të parashtruara nga funksioni aktual, por nga funksionet e mëparshme që i kanë ushtruar personat e zgjedhur dhe të emëruar. Kështu ndodh edhe me funksionarët e lartë.

Gjithashtu është i pakuptueshëm fakti që sistemi elektronik veçmas i regjistron deklaratat e paraqitura deri në fund të vitit 2023 dhe veçmas ato të paraqitura pas datës 1 janar 2024. Në të njëjtën kohë, jo të gjitha të dhënat e paraqitura në deklaratat për gjendjen pasurore dhe interesat për të gjithë bartësit e funksioneve që janë dorëzuar në format letrë deri më 31 dhjetor 2023 janë në dispozicion për publikun. Më konkretisht, në të dhënat elektronike që janë në dispozicion për publikun, KSHPK-ja i ka transferuar vetëm të dhënat për gjendjen pasurore, por jo informacionet për interesat e deklaruara. Prandaj, për nevojat e këtij hulumtimi, në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë tek Informacionet me Karakter Publik, nga KSHPK-ja janë kërkuar deklarata me shkrim të paraqitura nga personat e zgjedhur dhe të emëruar. Tërë procesi i mbledhjes së deklaratave zgjati 4 muaj sepse shërbimet profesionale të KSHPK-së kishin mundësinë për të anonimizuar dhe të dërgojnë përafërsisht vetëm nga 60 deklarata në muaj.

- **Qytetarët e kanë të pamundësuar që në mënyrë aktive të marrin pjesë në zbulimin e konfliktit të mundshëm të interesave dhe keqpërdorimeve të pushtetit nga ana e bartësve të funksioneve. Regjistri për Pronarët e Vërtetë nuk është i hapur për publikun dhe qasja tek informacionet në të është me pagesë, ndërkaq të dhënat për interesat financiare të funksionarëve që janë në sistemin elektronik të KSHPK-së nuk janë të plota.**

Konfigurimi aktual i sistemit nuk ua mundëson qytetarëve të marrin pjesë në procesin e verifikimit të saktësisë së të dhënave për pronësinë e funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar. Ata nuk kanë qasje tek informacionet për pronarët e kompanive konkrete, që të mund ta alarmojnë publikun dhe institucionet kompetente për rastet kur ndonjë bartës i funksionit publik është në marrëdhënie të ngushta me ndonjë kompani konkrete.

Në të njëjtën kohë, qytetarët nuk mund të krijojnë as qëndrim të informuar lidhur me atë nëse bartësit e funksioneve të larta po e përdorin pushtetin që u është besuar për t'ua mundësuar kompanive që janë në pronësi të personave të afërt me ta të fitojnë kontrata për prokurime publike, kontrata për partneritet publik-privat ose kontrata për koncesion.

Në kushte kur për informacionet për pronësi duhet të paguhet, bëhet më e lehtë edhe për pronarët e kompanive të fshehen sepse verifikimi i të dhënave nuk është një proces në të cilin marrin pjesë numër më i madh i qytetarëve, i shoqatave qytetare ose i mediave.

Kur ky fakt do të ndërlihet me faktin se deklaratat e interesave që i paraqesin personat e zgjedhur dhe të emëruar në shumë raste nuk janë objektive, gjithëpërfshirëse dhe të sakta, cilësia e procesit të zbulimit të interesave të personaliteteve politike vihet në pikëpyetje.

